

TECHNICAL DATA SHEET

VERTIKOLL C1TE

PËRSHKRIMI

Ngjitës pllakash me bazë çimento, me performance të lartë, zhvilluar për aplikim të lehtë dhe rezultat të qëndrueshëm në vendosjen e pllakave qeramike. Falë punueshmërisë së mirë, kohës së gjatë të punës dhe rezistencës ndaj rrëshqitjes, produkti mundëson ngjitje më të saktë, më efikase dhe të lehtë, edhe në sipërfaqe vertikale. Formula siguron ngjitje të mirë, rezistencë ndaj lagështisë në kushte normale përdorimi dhe ngurtësim të njëtrajtshëm.



KLASIFIKIMI SIPAS STANDARTIT

Ngjitës për pllaka me bazë çimento (C), me forcë ngjitëse normale (I) rezistent ndaj rrëshqitjes (T) dhe kohë punueshmërie e gjatë (E). I klasifikuar si ngjitës C1TE sipas standartit EN 12004. Vertikoll ka emetime shumë të ulëta të VOC-ve, (komponimeve organike të avullueshme), duke kontribuar në mbrojtjen e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë së aplikatoreve, sipas kërkesave EC1 Plus.

FUSHA E APLIKIMIT

Zgjidhje praktike dhe e besueshme për vendosjen e pllakave qeramike dhe gres-porcelani në dysheme dhe mure. I përshtatshëm për ambiente të brendshme dhe të jashtme, mbi sipërfaqe me bazë çimento. Formula e tij mundëson aplikim të lehtë, vendosje të qëndrueshme dhe ngjitje efikase për pllaka me dimensione 5–60 cm.

MENYRA E PËRGATITJES SE PERZIERJES

Përzieri 6-6.5 litra ujë të pastër me 25 kg Vertikoll, me një përzierës elektrik derisa të formohet një masë homogjene dhe pa kokërriza. Lëreni në qetësi për 10 minuta dhe më pas përzieri përsëri përpara përdorimit. Koha e punueshmërisë së përzierjes është 2-3 orë.

PËRGATITJA E SUPORTIT

Të gjitha tipet e suporteve me bazë çimento duhet të pastrohen paraprakisht përpara se të aplikohet produkti. Suporti mund të përmbajë papasterti të tilla si pluhura, vajra apo mbetje të ndryshme të cilat ndikojnë negativisht në forcën ngjitëse të produktit. Pastrimi mund të bëhet në mënyrë mekanike. Përpara aplikimit të produktit sipërfaqja e suportit duhet të spërkatet me ujë në mënyrë që produkti të krijojë një ngjitje sa më të mirë dhe të ketë një kohë punueshmërie sa më optimale.

APLIKIMI

Fillimisht produkti rekomandohet të shtrohet me pjesën e drejtë të mallës për të pasur një shpërndarje sa më të njëtrajtshme dhe me pas me pjesën e dhëmbëzuar. Aplikimi bëhet me një mallë të përshtatshme në varësi të llojit të pllakës që shtrohet. Vendosja e pllakave bëhet duke ushtruar një presion të vogël mbi pllakë duke u siguruar që pllaka të mbulohet në të gjithë sipërfaqjen me kollë. Konsumi 3-5 kg/m² sipas dimensioneve të dhëmbëzimit të mallës dhe tipit të bazamentit.

TECHNICAL DATA SHEET

VERTIKOLL CITE

TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja:	Pluhur
Paketimi:	Thes letre 25 kg në paleta 1350 kg
Ngjyra:	E bardhë/Gri
Konsumi:	3-5 kg/m ²
Rrëshkitshmëria:	≤0,5 mm
Magazinimi:	Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri
Koha e Magazinimit:	12 muaj nga data e prodhimit
Masa Vëllimore:	1.5-1.6 gr/cm ³
Reaksioni ndaj zjarrit:	Klasa A1
Ujë për përzierje:	6-6.5 litra ujë për 25 kg
pH i përzierjes:	13
Temperatura e aplikimit:	+5°C deri në +35°C
Koha e korigjimit:	30 min
Mbushja e fugave në mure:	Pas 8 deri 12 orësh
Mbushja e fugave në dysHEME:	Pas 24 orësh
FN* pas 28 ditësh:	≥0,5 N/mm ²
FN* pas zhytjes në ujë:	≥0,5 N/mm ²
FN* pas reaksionit nga ngrohja:	≥0,5 N/mm ²
FN* pas cikleve ngrirje-shkrirje:	≥0,5 N/mm ²
FN* pas 20 min:	≥0,5 N/mm ²
I shkelshëm:	Pas 24 orësh

KUJDES!

Si temperaturat e uleta dhe temperaturat e larta mund të ndryshojnë karakteristikat e punimit të produktit (ngadalesim ose përsëritje në tharje të produktit).

Mos e përdorni në:

1. Suporte druri,metali, PVC apo sipërfaqe të tjera jo me bazë çimento.
2. Për pllaka me dimensione të mëdha dhe të rënda.
3. Për ambiente me ngrohje qendrore, në ambiente ku ka lagështirë të vazhdueshme, suporte që karakterizohen nga vibrime të paqëndrueshme.
4. Në temperature të larta, të ulëta me ere te forte.